



# ASSE Newsletter

*Nr. 1*

*Maj 2010*

## *Në këtë numër:*

<b>Përse ASSE?</b>	<b>1</b>
<b>Si të anëtarësohemi në ASSE?</b>	<b>2</b>
<b>Përfitimet nga anëtarësimi në ASSE</b>	<b>3</b>
<b>ASSE Newsletter</b>	<b>3</b>
<b>Përfaqësimi i ASSE-s në ESSE</b>	<b>4</b>
<b><i>Call for papers</i></b>	<b>5</b>

## Përse ASSE?

ASSE është Shoqata Shqiptare për Studimet në Gjuhën Angleze e njohur zyrtarisht me shkurtime ASSE (Albanian Society for the Study of English). Ajo u themelua në nëntor 2009 në Vlorë me iniciativën e një grupi anëtarësh të stafit akademik të Departamentit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Vlorës. Themelimi i ASSE-s shënoi kurorëzimin e prej më shumë se një viti përpjekjesh për ndërtimin dhe përcaktimin e qartë të misionit të saj.

Po çfarë përfaqëson ASSE për studimet angleze në vend? Cila është rëndësia e përfaqësimit në ASSE?

ASSE synon të bëhet përfaqësimi më dinjitoz për njohjen e studimeve angleze dhe amerikane në vend. Misioni i ASSE-s është që të krijojë një hapësirë të mirëfilltë shkencore për të gjithë ata studiues që punojnë kryesisht në nivelin universitar dhe që merren me studime në gjuhën angleze. Ajo synon ta realizojë këtë përmes aktiviteteve të ndryshme shkencore si konferenca, seminare dhe botime të ndryshme shkencore.

ASSE lindi si një domosdoshmëri për të nxitur dhe promovuar përpjekjet e kërkuesve të brezit të ri dhe të vjetër në fushën e anglistikës, duke u bërë kështu mbështetësi kryesor i kërkimit shkencor në këtë drejtim. ASSE synon ta përçojë mendimin shkencor shqiptar jo vetëm në arenën kombëtare, por edhe në atë ndërkombëtare duke ndërvepruar me shoqatat simotra që veprojnë në shumë vende të Evropës dhe duke u përfaqësuar në ESSE (European Society for the Study of English).

ESSE është përfaqësimi më i lartë evropian i studimeve në gjuhën angleze. Përfaqësimi i mendimit shkencor shqiptar në këtë shoqatë do ta bënte atë jo thjesht të njohur në rang botëror, por do ta bënte atë të pranishëm në shumë aktivitete shkencore të organizuara për të nxitur kërkimin në këtë fushë.

Le t'i urojmë ASSE-s rrugë të mbarë në përmbushjen e këtij misioni!



## ASSE Newsletter

Nr.1

Maj 2010

### Si të anëtarësohemi në ASSE?

Më poshtë po ju njohim me nenet 4 dhe 5 të statutit të ASSE-s që lidhen me anëtarësimin dhe procedurat e anëtarësimit. Të interesuarit për të aplikuar për tu bërë anëtarë të ASSE-s mund të konsultojnë *website*-in e ASSE-s dhe më pas të plotësojnë formularin përkatës për aplikim anëtarësimi në ASSE.

#### Neni 4 - Anëtarësimi

ASSE është shoqatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e hapur për të gjithë ata kërkues, mësimdhënës, specialistë të studimeve të gjuhës angleze që punojnë në nivelin universitar në Shqipëri. Shoqata mirëpret gjithashtu të gjithë ata kërkues, mësues e specialistë ndërkombëtarë që punojnë dhe kontribuojnë për nxitjen e këtyre studimeve në Shqipëri.

Anëtarët e shoqatës përbëhen nga dy kategori:

- a) Anëtarët e thjeshtë me të drejta dhe detyrime të plota: këtu bëjnë pjesë të gjithë ata studiues, kërkues, mësimdhënës të gjuhës angleze që operojnë në nivelin universitar përmes aktivitetit të tyre mësimdhënës, kërkues e shkencor.
- b) Anëtarë nderi: këtu bëjnë pjesë të gjithë ata njerëz dhe personalitete me kontribute të veçanta në studimin e anglishtes në Shqipëri. Statusi i anëtarit të nderit propozohet nga Këshilli Drejtues i ASSE-s në bazë të kriterëve të përcaktuara paraprakisht dhe miratohet në Mbledhjen e Përgjithshme. Anëtarët e nderit çlirohen nga detyrimi i kuotës së anëtarësimit dhe gëzojnë të njëjtat të drejta me anëtarët e thjeshtë të ASSE-s.

#### Neni 5 - Procedura e anëtarësimit

Çdokush me interesa profesionale e shkencore në studimet angleze që punon në nivelin universitar mund të aplikojë për tu anëtarësuar në ASSE. Për tu anëtarësuar, personat që dëshirojnë të bëjnë pjesë në ASSE duhet fillimisht të plotësojnë një formular elektronik, i cili përmban pyetje që verifikojnë statusin e aplikuesit dhe provojnë njohjen e tij me statutin e ASSE-s. Të drejtën për miratimin e aplikimeve për anëtarësim e ka Këshilli Drejtues. Pas anëtarësimit, këta persona duhet të paguajnë kuotën vjetore të anëtarësimit dhe të regjistrohen në listën e anëtarëve. Përfshihen nga kuota e anëtarësimit anëtarët e nderit të shoqatës.



# ASSE Newsletter

*Nr. 1*

*Maj 2010*

## Përfitimet nga anëtarësimi në ASSE

Anëtarësimi në ASSE është një perspektivë me përfitime shkencore si në një plan të gjerë ashtu edhe në një plan më individual. Duke u anëtarësuar në ASSE çdo anëtar i saj do të ketë mundësinë të kontribuojë me veprimtarinë e vet shkencore në përparimin e studimeve në gjuhën angleze në Shqipëri. Krijimi i kësaj hapësire shkencore do të bashkojë gjithë ata studiues të vjetër dhe të rinj që potencialin e tyre intelektual e kanë investuar në këto studime. Qëllimi i këtij bashkimi intelektual dhe akademik nuk është thjesht promovimi i punës individuale të secilit, por më mbi të gjitha krijimi i një karakteri përfaqësues shkencor të të gjithë përpjekjeve të studiuesve dhe kërkuesve që veprojnë në këtë fushë. Përveç studiuesve shqiptare ASSE mirëpret edhe studiues të huaj që ushtrojnë veprimtarinë e tyre akademike në Shqipëri, duke e parë kontributin e tyre si të pandashëm nga kontributi i studiuesve shqiptare.

Duke paguar kuotën e anëtarësimit çdo anëtar i ASSE-s gëzon të drejtën për :

- Tu abonuar në *in esse*: English Studies in Albania, i cili është buletini shkencor që botohet nga ASSE dy herë në vit.
- Tarifa të reduktuara për të marrë pjesë në konferencat ndërkombëtare të organizuara nga ASSE.
- Të drejtën për të dorëzuar artikuj për botim në *in esse*.

## ASSE Newsletter

ASSE boton çdo muaj *newsletter*-in e vet. Ky *newsletter* do të shërbejë si zëri i përmuajshëm i ASSE-s për të përcjellë mesazhe të ndryshme, për të botuar njoftime në lidhje me thirrje për konferenca apo buletine brenda dhe jashtë Shqipërisë. ASSE fton të gjithë ata që dëshirojnë të botojnë mendimet e tyre në lidhje me çështje që prekin probleme të karakterit shkencor apo edhe teknik në lëmin e studimeve në gjuhën angleze. Gjithashtu nëse keni thirrje të ndryshme për të botuar me qëllimin për t'i bërë të ato njohura, ASSE ju mirëpret të kontaktoni në adresën elektronike [bleditoska@univlora.edu.al](mailto:bleditoska@univlora.edu.al).



# ASSE Newsletter

*Nr.1*

*Maj 2010*

## Përfaqësimi i ASSE-s në ESSE

ASSE synon që shumë shpejt të bëhet pjesë e ESSE-s, Shoqatës Evropiane për Studimet në Gjuhën Angleze. Për të kuptuar më mirë rëndësinë e përfaqësimit të ASSE-s në ESSE, po ju paraqesim një përshkrim të shkurtër të ESSE-s dhe misionit të saj.

ESSE u themelua në Romë në janar 1990 si bashkim evropian i shoqatave kombëtare për studimin e anglishtes që vepronin në nivelet e arsimit të lartë. Shoqata synon të pasqyrojë diversitetin kulturor dhe gjeografik të Evropës në institucionet e saj. Synimi i saj është të çojë përpara arsimimin e publikut përmes nxitjes së studimeve në gjuhën angleze dhe të kuptuarin e gjuhëve angleze, letërsive në anglisht dhe kulturave të vendeve anglishtfolëse.

ESSE përpiket që të:

- Organizojë rregullisht konferenca për kërkues dhe mësimdhënës të gjuhëve angleze, letërsive në anglisht dhe kulturave të vendeve anglishtfolëse.
- Mbështesë rrjetet kërkuese me qëllimin për të bashkuar kërkues dhe studiues dhe për të lehtësuar bashkëpunimin e tyre intelektual. ESSE boton një buletin shkencor *European Journal of English Studies (EJES)* në bashkëpunim me Routledge.
- Sigurojë një rrjet informacioni në formën e një *newsletter-i (The Messenger)* për çështje që lidhen me studimet në Evropë si zhvillime kurrikulash, konferenca kombëtare, projekte kërkimore të specializuara.
- Sigurojë informacion për të lehtësuar shkëmbimet midis anëtarëve të fakulteteve dhe studentëve përmes programeve ndërkombëtare të bashkëpunimit, veçanërisht ato të Bashkimit Evropian. ESSE ofron edhe një skemë burse për të mbështetur studiuesit e rinj.



# ASSE Newsletter

*Nr.1*

*Maj 2010*

- Discourse Analysis
- Pragmatics
- Linguistics
- Semiotics
- British and Commonwealth Literature
- American Literature
- Literary Theory
- Literary Criticism
- Cultural Studies
- Translation Studies

The conference language is English. All papers will be considered for publication in the conference proceedings. Further information is available on our conference website: <http://univlora.edu.al/fe/lang/al/konf/Home.html>

Please send your abstracts (about 250 words) for papers (20 min) as an MS word attachment to the following Email-address by 1 June 2010: [sau2010@univlora.edu.al](mailto:sau2010@univlora.edu.al)

Abstracts should include:

1. title of paper
2. name and affiliation
3. e-mail address
4. section
5. 3-5 keywords

## Call for Papers

### English(es)

#### *in esse*: English Studies in Albania

Deadline for submitting articles: 30 July 2010

ASSE (Albanian Society for the Study of English) and the Department of Foreign Languages, University of Vlora would like to announce this call for papers for contributions for its first issue of *in esse*: **English Studies in Albania**, which is a scholarly journal devoted to the promotion of original work in linguistics, literary and translation studies and language teaching by scholars working in Albania and abroad.

The present issue is entitled simply *English(es)* and aims at bringing together new and intriguing perspectives and responses on matters of English or Englishes.

Deadline for submissions: 30 July 2010

Articles should not exceed 6000 words. Please send articles as an e-mail attachment to Doc. Armela Panajoti ( [armelap@univlora.edu.al](mailto:armelap@univlora.edu.al) ) or Doc. Bledar Toska ( [bleditoska@univlora.edu.al](mailto:bleditoska@univlora.edu.al) ). Please include a 250-word abstract and 4-5 keywords. Please follow the Chicago Manual of Style (15th edition) for citation.